



NPL "STACIONI I AUTOBUSEVE" SH.A. PRISHTINË
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

RREGULLORE PËR PENSIONIM TË PARAKOHSHËM TE PUNONJESVE TE NPL "STACIONI I AUTOBUSEVE" SH.A. PRISHTINE

Prishtinë, Tetor 2019

N.P.L " Stacioni i Autobusëve"SH.A. - Prishtinë
Rr. Bill Clinton, p.n – Prishtinë/ Kosovë
+383 (38) 551 333
info@sap-rks.com
www.sap-rks.com;

Në bazë të te Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike nenit 20 të Ligjit Nr-04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087 për Ndërmarrje Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 13/2012), nenit 8 pika 3 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A.- Prishtinë, Bordi Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më datë 24.10.2019, miraton këtë:

RREGULLORE PËR PENSIONIM TË PARAKOHSHËM

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për pensionim të parakohshëm të punëtorëve të N.P.L "Stacioni i Autobusëve"SH.A. (në tekstin e mëtejme "ndërmarrja").

Neni 2

Fushëveprimtaria

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjithë punëtorët e rregullt të ndërmarrjes me rastin e pensionimit të parakohshëm.

Neni 3

Rastet për pensionim të parakohshëm

1. Punëtori i ndërmarrjes, nën kushtet e parapara me këtë Rregullore, mund të kërkojë pensionim të parakohshëm jo më shumë se 5 vite para afatit të përcaktuar për pensionim të tij.
2. Punëtori i cili ka probleme shëndetësore dhe nuk ka aftësi punuese ka të drejte po ashtu të beje kërkesë për punësim të parakohshëm edhe para afatit të përcaktuar në piken 1 të këtij neni - duke dëshmuar shkallen e paaftësisë në baze të dokumentacionin valid të lëshuar nga institucionet përkatëse.
3. Te drejte për kërkesë për pensionim të parakohshëm kanë të gjithë at atë cilët i kanë të paktën 10 vite përvojë punë në ndërmarrje.

Neni 4

1. Punëtori i cili i plotëson kushtet e parapara me nenin 3 të kësaj Rregulloreje, duhet të plotësojë kërkesën për pensionim të parakohshëm.
2. Kërkesa, sipas paragrafit 1 të këtij neni, i dërgohet Burimeve Njerëzore, e cila do të verifikojë nëse plotësohen kushtet e parapara me këtë Rregullore brenda afatit prej 3 ditëve pune.

3. Burimet Njerëzore në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, ia dërgojnë kërkesën udhëheqësit të drejtpërdrejtë të punëtorit për të dhënë pëlqimin e tij.
4. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë shqyrton kërkesën, duke marrë parasysh:
 - a) Rëndësinë e punës që kryhet nga punëtori në kuadër të njësisë organizative;
 - b) Dallimin ndërmjet kostos së pagës dhe kompensimet e punëtorit që pensionohet dhe të pagës së punëtorit që e zëvendëson atë (nëse ka nevojë);
 - c) Planifikimin e personelit në njësinë organizative;
 - d) Mundësinë e zëvendësimit adekuat dhe/apo mundësinë e kryerjes së detyrave të tij nga radhët e punëtorëve të tjerë
5. Pas shqyrtimit të kërkesës, sipas paragrafit 4 të këtij neni, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i punëtorit që kërkon pensionim të parakohshëm, jep mendimin e tij dhe në afat prej 5 ditëve të punës, i dërgon Burimeve Njerëzore.
6. Pas marrjes së mendimit nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, Burimet Njerëzore kompletojnë lëndën e punëtorit që kërkon pensionim të parakohshëm dhe i dërgon Kryeshefit Ekzekutiv.
7. Kryeshefi Ekzekutiv shqyrton kërkesën së bashku me të gjitha shkresat e lëndës dhe mendimin e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të punëtorit dhe merr vendim aprovues apo refuzues në bazë të kësaj Rregulloreje në afat prej 7 ditëve të punës.

Neni 5

Përmbajtja e vendimit për pensionim të parakohshëm

1. Vendimi për aprovimin e kërkesës për pensionim të parakohshëm të punëtorit, përveç tjerash duhet të përmbajë:
 - a) Datën e pensionimit të parakohshëm të punëtorit;
 - b) Pagesën për pensionim të parakohshëm;
 - c) Obligimet e punëtorit ndaj ndërmarrjes sipas dispozitave ligjore në fuqi, dhe
 - d) Pika të tjera me rëndësi që vlerësohen nga ndërmarrja.
2. Kryeshefi Ekzekutiv nxjerr vendim edhe në rast të mos aprovimit të kërkesës.
3. Burimet Njerëzore e njoftojnë punëtorin në lidhje me vendimin e marrë nga Kryeshefi Ekzekutiv në afat prej 3 ditëve të punës.

Neni 6

Pensionimi i parakohshëm me iniciativë të ndërmarrjes.

1. Ndërmarrja mund të kërkojë pensionim të parakohshëm për punëtorin me iniciativë të sajë në këto raste:
 - a) Me rastin e riorganizimit të sajë, dhe punëtori cilësohet si tepricë;
 - b) Kur njësi organizative e punëtorit shuhet apo bashkohet me një njësi tjetër organizative dhe punëtori cilësohet si tepricë;
3. Pensionimi i parakohshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet vetëm nëse punëtori është jo më shumë se 5 vite para moshës së pensionimit.

Neni 7

Njoftimi për pensionim të parakohshëm nga ndërmarrja

Ndërmarrja, në pajtim me pikën a dhe b të paragrafit 1 të nenit 6 të kësaj Rregulloreje, duhet të njoftojë punëtorin së paku 6 muaj para datës së pensionimit të parakohshëm.

Neni 8

1. Burimet Njerëzore në pajtim me pikat a dhe b të paragrafit 1 të nenit 6 të kësaj rregulloreje do të i identifikojnë punëtorët të cilat i kanë dhe 5 vite para moshës së pensionimit.
2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, Burimet Njerëzore i dërgojnë Kryeshefit Ekzekutiv të dhënat e punëtorëve, që kanë arritur moshën e pensionimit të parakohshëm.
3. Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes, shqyrton të dhënat e dërguara nga Burimet Njerëzore dhe vendosë për çdo rast me vendim për pensionim të parakohshëm.

Neni 9

Kompensimi për pensionim të parakohshëm

1. Punëtori që pensionohet para kohe sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, në bazë të kërkesës së tij apo të ndërmarrjes, do të i paguhet paga si në vijim:

- a) Viti i parë i pensionimit të parakohshëm 90% të bruto pagës sipas kontratës së fundit (64 vjeç);
- b) Viti i dytë i pensionimit të parakohshëm 80% të bruto pagës sipas kontratës së fundit (63 vjeç);
- c) Viti i tretë i pensionimit të parakohshëm 80 % të bruto pagës sipas kontratës së fundit (62 vjeç);
- d) Viti i katërt i pensionimit të parakohshëm 75 % të bruto pagës sipas kontratës së fundit (61 vjeç);
- e) Viti i pestë i pensionimit të parakohshëm 70 % të bruto pagës sipas kontratës së fundit (60 vjeç).
- f) Te gjithë ata te cilët janë te pafte për pune dhe i plotësojnë kushtet e nenit 3 dhe i miratohet pensionimi i parakohshëm gëzojnë te drejtën e pagesës prej 70% te pagës, sipas kontratës se fundit.

2. Pagesa e pensionimit të parakohshëm bëhet derisa punëtori të arrijë moshën e pensionimit prej 65 vjeç.

3. Punëtori është i obliguar të paraqitet në ndërmarrje deri më datën 10 te çdo fillim të 3 mujorit, në të kundërtën, ndërmarrja ndalon çdo pagesë për punëtorin.

3.1. Me rastin e paraqitjes së punëtorit në ndërmarrje sipas paragrafit 3 të këtij neni, i njëjti nënshkruan në formularin përkatës si dëshmi për paraqitje fizike në ndërmarrje.

3.2. Punëtori i cili nuk mund të veproj sipas paragrafit 3 të këtij neni, duhet të dëshmoj mosparaqitjen e tij, më së largu 3 ditë pas përfundimit të shkakut, në të kundërtën ndërmarrja ndalon çdo pagesë për punëtorin.

3.3. Me rastin e vdekjes së punëtorit i cili është në pensionim të parakohshëm, pushojnë të gjitha detyrimet e ndërmarrjes ndaj punëtorit.

4. Punëtorit nuk i takon asnjë pagesë tjetër shtesë - pagesa e stazhit (kohës se kaluar ne pune) dhe pagesa e shujtës, përveç pagesës sipas pikës 1 të këtij neni, përveç nëse është paraparë ndryshe me këtë Rregullore.

Neni 10

Detyrimet e punëtorit

1. Punëtori gjatë kohës së pensionimit të parakohshëm nuk ka të drejtë të themelojë marrëdhënie të re të punës apo të kërkojë të kthehet në punën në ndërmarrje.
2. Në rast se vërtetohet që punëtori ka themeluar marrëdhënie të re të punës, atëherë ndërmarrja gëzon të drejtën e shkëputjes së të gjitha marrëdhënieve juridike me punëtorin.
3. Ndërmarrja mund të ftoj punëtorin për konsultim, në lidhje me ndonjë çështje të punës, për të cilën punëtori ka apo mund të ketë njohuri.

Neni 11

Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve pas miratimit paraprak nga ana e Bordit të Drejtorëve.

Prishtinë, më ____/____ 2019

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Faton Raci

